



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-11741/17

Dt.06.07.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit: **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** e komunës së Gjakovës, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit ekonomik – qendër grumbulluese e mjaltit dhe hapësira trajnuese, në Gjakovë me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, nenit 25.2 të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Planifikimin dhe Ndërtimin e objekteve në territorin e Komunës së Gjakovës 01 Nr 011-2233 të datës 31.03.2011 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM



I. I LEJOHET aplikuesit: **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** e komunës së Gjakovës, ndërtimi i objektit ekonomik – qendër grumbulluese e mjaltit dhe hapësira trajnuese, në Gjakovë, sipas Projektit të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjakovës, Rregulloren komunale mbi rregullat dhe procedurat për planifikimin dhe ndërtimin e objekteve në territorin e Komunës së Gjakovës, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 396/3, Z.K. Brekoc, në pronësi të P.SH. "Kuvendi i Komunës Gjakovë", e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit prej **S=214 m²**

Përdhesa: (Sip,Bruto): **S=107 m²**
Kati i parë: (Sip,Bruto): **S=107 m²**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit ekonomik – qendër grumbulluese e mjaltit dhe hapësira trajnuese, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja "VB.TOFAJ"SH.P.K. -Junik.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e komunës së Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-11741/17 të datës 11.05.2016 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit ekonomik – qendër grumbulluese e mjalit dhe hapësira trajnuese, në Gjakovë, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 396/3, Z.K. Brekoc, në pronësi të P.SH. "Kuvendi i Komunës Gjakovë", siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 07.06.2017, të vërtetuar nga D.U.M.M.-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 18.03.2017 (fotokopje) në pronësi të P.SH."Kuvendi i Komunës Gjakovë" lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikata mbi të drejtën në pronë e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 1500/17, të datës 17.03.2017 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Përfundimi nga Bordi i Drejtorëve i Komunës së Gjakovës, me nr. 01 Nr.060/01-6094-4/1, datë 23.03.2017, mbi aprovimin e kërkesës së për Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës grumbulluese të mjaltes në Gjakovë.
5. Qendra grumbulluese për qumësht nuk i nënshtrohet procedurave të Lejes Mjedisore Komunale, bazuar në Udhëzimin Administrativ me nr.01/2017, për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale-Listën e Aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale.
6. Pëlqimin Sanitar me nr.14/53/10514, dt.05.05.2016, nga Inspektorati Sanitar Komunal, Drejtoria e Inspeksionit.
7. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 11.05.2017.
8. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.-Gjakovë, me nr.1293, të datës 05.05.2016.
9. Pëlqimin nga PTK-Vala, me nr.24, të datës 03.05.2017.
10. Vërtetimin nga KRM "Çabrat"SHA, me nr.387, dt.03.05.2017.
11. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja "VB.TOFAJ"SH.P.K. -Junik.

LIROHET nga pagesa e taksës administrative, në bazë të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale me nr.01.Nr.011-43964/2015 të dt.30.06.2015, Nenit 5.15.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspeksionit ,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxhe dipl.e ark.

KOPJE PLANI

Zona kad. Brekoc

Shk. zvog. 1: 2500

Poseduesi: P.Sh Kuvendi Komunes Gjakovë



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m	
103-0			Varrezë	3		40	29	
Gjithësejtë						40	29	


Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

K.K. GJAKOVË
Z.K. :Brekoc
Ng. nr. 306-3.

PLAN SITUACIONI

KOORDINATAT PER PIKETIM TE OBJEKTIT

1. X=7451781.1103 Y=4691904.6002
2. X=7451785.7117 Y=4691906.9352
3. X=7451784.8067 Y=4691908.7187
4. X=7451787.7494 Y=4691910.2121
5. X=7451787.2969 Y=4691911.1038
6. X=7451793.7621 Y=4691914.3846
7. X=7451797.3823 Y=4691907.2506
8. X=7451783.3729 Y=4691900.1414



Gjakovë,
07.06.2017

Punoi: Fatmir Bobi tek.

Kontrollori: Durrije Berisha I.D.A.

Fatmir Bobi tek.

Durrije Berisha